



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.Dh.Sh.II.nr.157/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS– Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Banka Ekonomike Sh.A., me seli në Prishtinë, e përfaqëson me autorizim Muhamet Durmishi, avokat nga Kompania e Avokatëve Arbëresh me seli në Prishtinë, kundër debitorëve: 1. D.P.Z. Argjetaria Blina me seli në Glllogoc, rr. Ganimete Terbeshi, nr. 16, me pronar B.E., me autorizim e përfaqëson Gazmend Halilaj avokat nga Glllogoci, 2. H.K. nga fshati Glllobar, Komuna e Glllogocit, huamarrëse, 3. Rr.K. nga fshati Glllobar, Komuna e Glllogocit dhe 4 I.K. nga fshati Terstenik, Komuna e Glllogocit, me objekt përmbartimi pagesën e kredisë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.369/2023 të datës 10.11.2023, me datën 19.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Banka Ekonomike Sh.A., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.369/2023 të datës 10.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.369/2023 të datës 10.11.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbartimit D.P.Z. Argjetaria Blina me seli në Glllogoc, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit numër P.nr.234/2014 të datës 29.08.2014, i lejuar nga Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, në pikën II

e ka shfuqizuar urdhërin përbarimit P.nr.234/2014 të datës 29.08.2014, i lejuar nga Përbaruesit Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë kanë parashtruar kreditori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përbarimore, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tërësi si e bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i ankimuar si dhe mbetet në fuqi urdhëri përbarimor P.nr.234/2014 të datës 29.08.2014.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Zyra Përbarimore e përbaruesit privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përbarimor me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të Marrëveshjes mbi Pengun nr. 52979 të datës 05.07.2011 për sigurimin e Marrëveshjes kreditore nr. 52979 e datës 05.07.2011, e regjistruar sipas Certifikatës për regjistrimin e pengut në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë R-20140630-104 me datë 30.06.2014 dhe përfundim me datën 30.06.2017, mbi borxhin total prej 2,637.72 euro, me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kundër propozimit për përbarimin, prapsim ka paraqitur debitori në afat të rregullt ligjor, me të cilin ka theksuar se debitori me anë të këtij prapësimi në tërësi e kundërshton urdhrin e përbaruesit privat për arsye se ka emigruar jashtë shtetit dhe ka qëndruar në burg 4 vite, pasi që jetoj në kushte të vështira ekonomike, vetëm me ndihmë sociale. Me tej të njëjtit kanë shtuar se në rastin konkret kërkon në mirëkuptim që të paguaj vetëm ka 50 euro në muaj dhe ka propozuar që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhëri përbarimor.

Kreditorët brenda afat ligjore kanë paraqitur përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar pretendimet e debitorëve, dhe duke propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorëve si i pa bazuar.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit dhe përgjigje në prapësim të kreditorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.369/2023 të datës 10.11.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit D.P.Z. Argjetaria Blina me seli në Gllogoc, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.234/2014 të datës 29.08.2014, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Destan Bujupaj, në pikën II e ka shfuqizuar urdhërin e përmbarimit P.nr.234/2014 të datës 29.08.2014, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë.

Gjykata shkallës së parë, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, deklarimeve gjatë seancës dëgjimore si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, dhe udhëzimeve të Dhomës së Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale, të dhëna në vendimin K.DH.SH.I.nr.67/22 të datës 06.02.2023, gjeti se sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: "Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligji nuk është parashikuar diçka tjetër", sipas nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se dokument përmbarues paraqet: " *...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.*". Ndërsa me nenin 27 par. 1 të LPP-së përcaktohet se "*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftëse në të ishte treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*". Gjithashtu sipas nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së përcaktohet se: 1. Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit - vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po që se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit., ndërsa me paragrafin 2 përcaktohet se: "*Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmbanë shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit,*

organi do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të LPK-së”. Pra ky propozim ka të meta ngase nuk është treguar dokumenti origjinal apo kopje e vërtetuar mbi bazën e së cilës është iniciuar procedura përbarimor sipas nenin 38 të LPP-së. Sipas dispozitës nga neni 43 para. 4 të LPP-së përcaktohet se: *“Në lidhje me ankesën që ngrëhë kundërshtimin ndaj urdhrin të përbarueshmërisë së nxjerrë nga përbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përbarim nga përbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim.”* Gjykata sqaron se kreditorit i është ofruar mundësia me afatë shtesë prej 7 ditësh që të sjellë dokumentacion origjinal, mirëpo i njëjti nuk e ka sjellë para gjykatës.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përbarimore. Konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore të procedurës përbarimore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së dytë vlerësoj se Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin kur ka vlersuar se baza juridike për caktimin e përbarimit, nuk i plotëson kushtet ligjore për tu caktuar përbarimin sipas dokumentit të përbarimit, ashtu si që parashihen me dispozitën e nenit 38 par.1 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, nr.05/L-118, pasi që në propozim nuk është treguar dokumenti origjinal apo kopje e vërtetuar mbi bazën e së cilën është iniciuar procedura përbarimore.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk qëndron pretendimi ankimor i debitorit se dokumenti në bazë të cilit është lejuar urdhri përbarimor paraqet dokument përbarimor, për shkak se në rastin konkret përbaruesi privat e ka lejuar përbarimin duke u bazuar në Marrëveshjes mbi Pengun nr. 52979 të datës 05.07.2011 për sigurimin e Marrëveshjes kreditore nr. 52979 e datës 05.07.2011, e regjistruar sipas Certifikatës për regjistrimin e pengut në Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë R-20140630-104 me datë 30.06.2014, të cilat nuk paraqesin dokumente përbarues

në kuptim të dispozitës së nenit 22 pika 1.7a të Ligjit për Procedurën Përmbaremore dhe ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore ashtu sipas nenit 5 me të cilën parashihet se; “2. Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragrafi ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.” E që në rastin konkret Marrëveshjes mbi Pengun nr. 52979 të datës 05.07.2011 për sigurimin e Marrëveshjes kreditore nr. 52979 e datës 05.07.2011 nuk është në origjinal, ngase këto kontrata janë dorëzuar në kopje të vulosur vetëm nga kreditori, kështu në këtë formë këto kontrata nuk i plotësojnë kushtet për të qenë tituj përmbaremore, ashtu sipas nenit 36 të LPP-së, me të cilën është paraparë se; “ Së bashku me propozimin për përmbaremore, organit përmbaremore i dorëzohet edhe dokumenti përmbaremore, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbaremore për përmbaremore”, andaj edhe kjo gjykatë vlerëson se si e tillë nuk përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbaremore dhe se nuk i plotësojnë kushtet ligjore nga neneve të lartëcekura, për të qenë të përmbaremore dhe të përshtatshëm për përmbaremore.

Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të ankimuar, mori parasysh të gjitha pretendimet ankimore të kreditorit sa i përket asaj se të gjitha dokumentet janë dorëzuar në origjinal tek përmbaremore duke paraqitur të gjitha kushtet e nevojshme për të qenë dokument përmbaremore, mirëpo të njëjtat i refuzojë si të pabazuara, me arsyetimin se dokumenti me të cilin përmbaremore private ka lëshuar urdhrin përmbaremore nuk është në origjinale dhe se ato nuk gjenden në shkresa të lëndës, edhe pse gjykata e shkallës së parë në seancën e datës 26.10.2023 e ka aprovuar kërkesën për afat shtese duke ia mundësia afatin prej 7 ditësh kreditorit për sjelljen e dokumentit në origjinal, mirëpo i njëjti nuk ia ka sjellur gjykatës të njëjtin. Prandaj, Kjo gjykatë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të ankimuar.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës ë Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Shk.II.nr.157/24, me datë 19.04.2023

Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri